

AKT THEMELUES
STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE
“NEVERMIND” SH.P.K

Në bazë të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit” dhe Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me vullnetin tim të lirë të shprehur në nënshkrimin e Aktit Themelues:

Unë Nevina Shtylla, e bija e Agimit Dtl. 30/05/1994 me ID J45530069D, banuese në Tiranë, sot më datë 10/06/2021 vendosa të krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme:

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqëria private e quajtur “NEVERMIND” sh.p.k. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptarë, ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues

SELIA E SHOQËRISË

NENI 2

Selia e shoqërisë tregtare private "NEVERMIND" sh.p.k. do të jetë: në rrugën Ferit Xhajko nd52, h15, ap3 ,Tiranë. Ajo mund të ketë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, perfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakëve themelues të saj.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:

1. Tregti me shumicë e pakicë me porosi me mail ose nëpërmjet internetit.
2. Tregtimit me shumicë e pakicë dhe import-eksport të syzeve të diellit dhe optike, veshjeve
3. Tregti mallrash me shumicë e pakicë brenda dhe jashtë vendit



4. Cdo veprimtari tjetër që lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi

NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

NENI 5

“Nevermind” sh.p.k kryen veprimtarinë e saj tregtare për një periudhë kohore të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga ortakët.

KAPITALI I SHOQËERISË

NENI 6

Kapitali Themeltare i Shoqërisë do të jetë 1,000 (një mijë) Lekë, i zotëruar nga ortakët si më poshtë:

Emër, Mbiemër	% që zotëron	Kuotat që zotëron
Nevina Shtylla	100%	1 kuotë

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet sipas vendimit të ortakut themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm

NENI 7

Ortakët duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajnë sekretin e saj dhe të mos dëmtojnë interesat e personave të tjerë dhe të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQËRISË

NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratorja Znj. Nevina Shtylla, e cila është përfaqësuese ligjore e saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej 1 (një) viti me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve të shoqërisë.

NENI 10

Ortakët themelues kanë të drejtë të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë. Kanë të drejtë të caktojnë financiar, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojnë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht tregucsit financiarë mujorë, tre-mujorë, 6- mujorë dhe vjetorë, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptarë në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.

NENI 13

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të norrnave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare "

NENI 14

Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlere të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qëndren Kombetare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare "NEVERMIND" sh.p.k.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

"NEVERMIND" sh.p.k

Znj. Nevina Shtylla

